



Slogan: Nga ideja në treg, ti je forca që e kthen produktin në sukses!

1. Pse një Master në “Marketing i Ushqimit dhe Biznes Digjital”

- Përmbush kërkesat e tregut të punës në fushën e marketingut ushqimor dhe biznesit digjital, një sektor i pambuluar me specialistë
- Pajis studentët me njohuri të plota në marketing, menaxhim biznesi dhe strategji digjitale.
- Përmirëson kompetencat e studentëve në hartimin e strategjive të marketingut, analizën e të dhënave dhe zhvillimin e tregjeve ushqimore.
- Përgatit studentët me aftësi shkencore dhe praktike për sukses në tregjet vendase dhe ndërkombëtare.

2. Kompetencat e të diplomuarve

- Hartimi dhe zbatimi i strategjive efektive të marketingut për sektorin agro-ushqimor.
- Analizë tregu, segmentim konsumatorësh dhe përdorim i të dhënave për vendimmarrje strategjike.
- Aplikimi i teknologjive digjitale si Search engine optimisation, media sociale dhe e-commerce për zhvillimin e biznesit.
- Menaxhim i produktit dhe markës si edhe komunikimi strategjik me konsumatorët në tregje të ndryshme.
- Kërkime tregu dhe interpretim i të dhënave për përmirësimin e performancës së biznesit
- Zhvillim i strategjive të eksportit dhe konkurrimit në tregjet ndërkombëtare agro-ushqimore.
- Hartimi dhe menaxhimi i projekte inovative dhe sipërmarrëse në sektorin agro-ushqimor.

3. Punëdhënësit e mundshëm dhe/ose rruga e karrierës

- **Menaxherë marketingu** në ndërmarrje agro-ushqimore, duke zhvilluar dhe zbatuar strategji marketingu për produkte ushqimore.
- **Specialistë të marketingut digjital** në agjenci marketingu, duke menaxhuar fushata online dhe platforma sociale.
- **Analistë tregu**, duke kryer studime mbi konsumatorët dhe trendet e sektorit agro-ushqimor.
- **Menaxherë të shitjeve dhe eksportit** në kompani që operojnë në tregje vendore dhe ndërkombëtare.
- **Specialistë të e-commerce** në platforma të tregtisë online ushqimore.
- **Specialistë në institucione publike ose organizata ndërkombëtare** në fushën e politikave ushqimore dhe zhvillimit rural.

- **Konsulentë të marketingut** dhe strategjisë digjitale për biznese në fushëm e ushqimit.
- **Zhvillues dhe sipërmarrës në startup-e** në sektorin e ushqimit dhe biznesit digjital.
- **Kërkues në institucione të arsimit të lartë**

4. Alumni të cilët mund të shërbejnë si shembull

1. Xhastin Lico

2. Melisa Llungu

3. Klevisa Biraci

5. Si zbatohet ndërdisiplinarteti i programit?

- 70 % Kreditë në Shkenca Ekonomike - Sociale
- 15 % Kreditë në Shkenca Natyrore
- 15% Kreditë në Shkenca Teknike

Gjatë zhvillimit të këtij programi është ndjekur parimi i qasjes ndërdisiplinore.

Kjo kurrikulë krijon ndërdisiplinartet përmes ndërthurjes së njohurive nga fusha të ndryshme si biznesi, marketingu, menaxhimi, teknologjia dhe industria ushqimore. Ajo kombinon ekonominë, statistikën dhe psikologjinë për të ndihmuar studentët të kuptojnë tregun, sjelljen e konsumatorit dhe dinamikën e biznesit. Në të njëjtën kohë, programi lidh teorinë e marketingut me aftësitë praktike të komunikimit, negocimit dhe menaxhimit të shitjeve. Dimensioni menaxhial forcohet përmes përfshirjes së strategjisë, organizimit, menaxhimit të projekteve, cilësisë dhe vendimmarrjes, duke i përgatitur studentët për situata reale në organizata dhe kompani. Gjithashtu, përmes perspektivës ndërkombëtare, studentët fitojnë njohuri mbi tregtinë globale, eksportin dhe funksionimin e tregjeve të huaja. Një element i rëndësishëm i kësaj kurrikule është lidhja me sektorin agro-ushqimor, ku ndërthuren marketingu me shkencat ushqimore, zhvillimin rural dhe qëndrueshmërinë. Po ashtu, komponenti teknologjik dhe inovativ pasurohet përmes njohurive mbi biznesin digjital, startup-et dhe shërbimet financiare moderne. Në këtë mënyrë, programi krijon një profil profesional të plotë, ku studenti zhvillon aftësi analitike, menaxheriale, teknologjike dhe sektoriale, duke qenë i përgatitur për kërkesat e tregut modern të punës.

6. Cilat programe Bachelor sugjerohen për këtë Master

Bachelor në fushën e Ekonomisë, Biznesit dhe Administrimit; Marketingut dhe Reklamimit si edhe Programe dhe kualifikime ndërdisiplinore që përfshijnë biznes, administrim dhe juridik.